



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Tiranë – E enjte, 23 mars 2017

PËRMBAJTJA

| | Faqe |
|--|---|
| Udhëzim i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 6, datë 7.3.2017 | Për një ndryshim në udhëzimin nr. 3, datë 13.2.2017, të ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë, viti shkollor 2016–2017”..... 3377 |
| Udhëzim i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 7, datë 10.3.2017 | Për datat dhe organizimin e provimeve të Maturës Shtetërore 2017..... 3377 |
| Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 19, datë 10.3.2017 | Me objekt: deklarimin e mbarimit të mandatit të anëtares së Gjykatës Kushtetuese, znj. Vitore Tusha..... 3378 |
| Njoftim i Ministrisë së Punëve të Jashtme, nr.3515, datë 15.3.2017 | Mbi hyrjen në fuqi të disa marrëveshjeve ndërkombëtare..... 3379 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 34, datë 2.3.2017 | Mbi miratimin e udhëzimit mbi kriteret për përcaktimin e aksesit në hapësirat e depozitimit të gazit natyror..... 3380 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 35, datë 2.3.2017 | Mbi fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit për certifikimin e operatorit të kombinuar të gazit natyror të “Albgaz” sh.a..... 3382 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 36, datë 6.3.2017 | Për licencimin e shoqërisë “ENPI Energji” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike..... 3383 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 37, datë 6.3.2017 | Për licencimin e shoqërisë “Balkan Energy Trade” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike..... 3384 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 38, datë 6.3.2017 | Mbi licencimin e shoqërisë “Energji Univers” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Kabash”, me fuqi të instaluar 5800 kW..... 3385 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 39, datë 6.3.2017 | Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Grid Energy” sh.p.k., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike..... 3385 |

| | | |
|---|--|------|
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 40, datë 6.3.2017 | Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Grid Energy” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike..... | 3386 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 41, datë 6.3.2017 | Për mosfillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “CGC” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të gazit natyror (shitje me shumicë)... | 3386 |
| Kërkesë e Ministrisë së Zhvillimit Urban nr. 1594, datë 10.3.2017 | Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, “Rikualifikim urban në territorin e Bashkisë Vlorë”, faza I..... | 3387 |
| | Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Sali (Mikel) Spahiu..... | 3389 |
| | Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Elidon Thoma Ndrio..... | 3389 |



UDHËZIM
Nr. 6, datë 7.3.2017

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN
NR. 3, DATË 13.2.2017, TË MINISTRIT TË
ARSIMIT DHE SPORTIT, “PËR
ZHVILLIMIN E PROVIMEVE
KOMBËTARE TË ARSIMIT BAZË, VITI
SHKOLLOR 2016–2017”

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 50, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1013, datë 10.12.2010, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 352, datë 3.4.2013, “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror të Arsimit,

UDHËZOJ:

1. Pika 1 e udhëzimit nr. 3, datë 13.2.2017, “Për zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë, viti shkollor 2016–2017”, ndryshon si më poshtë:

“1. Provimet kombëtare të arsimit bazë, për vitin shkollor 2016–2017, do të zhvillohen:

- a) Gjuhë e huaj, 12 qershor 2017;
- b) Gjuhë shqipe, 22 qershor 2017;
- c) Matematikë, 27 qershor 2017.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi zëvendësministri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Arsimit Parauniversitar, Drejtorja e Shërbimeve të Brendshme, Agjencia Kombëtare e Provimeve, Inspektorati Shtetëror i Arsimit, drejtoritë arsimore rajonale, zyrat arsimore dhe institucionet shkollore.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla

UDHËZIM
Nr. 7, datë 10.3.2017

PËR DATAT DHE ORGANIZIMIN E
PROVIMEVE TË MATURËS
SHTETËRORE 2017

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 26, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin

arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Lëndët dhe datat për provimet e Maturës Shtetërore 2017, të jenë:

- a) Gjuhë e huaj (D3) 5 qershor 2017;
- b) Gjuhë shqipe dhe letërsi (D1) 10 qershor 2017;
- c) Matematikë (D2) 15 qershor 2017;
- d) Provime me zgjedhje (Z1/Z2) 24 qershor 2017.

2. Administrimi i provimeve të Maturës Shtetërore 2017 të bazohet në Rregulloren e Maturës Shtetërore 2017 në Republikën e Shqipërisë, miratuar me urdhrin nr. 39, datë 31.1.2017, të ministrit të Arsimit dhe Sportit.

3. Drejtorja e Arsimit Parauniversitar dhe Agjencia Kombëtare e Provimeve, brenda muajit mars 2017, të përcaktojnë llojin e testeve për secilin provim të Maturës Shtetërore (të detyruar dhe me zgjedhje).

4. Provimet e detyruara dhe me zgjedhje të Maturës Shtetërore 2017:

4.1 Fillojnë në orën 10:00.

4.2 Provimet e detyruara zgjasin 2 orë e 30 minuta.

4.3 Provimet me zgjedhje zgjasin 3 orë.

4.4 Testet e provimeve të detyruara dhe me zgjedhje hartohen, administrohen dhe vlerësohen nga AKP-ja.

4.5 Testi për secilin nga provimet e detyruara përmban 25 pyetje, nga të cilat 13 kërkesa janë me përgjigje alternative, që vlerësohen me një pikë secila (13 pikë gjithsej) dhe 12 pyetje me zhvillim, të cilat vlerësohen me 37 pikë. Testi vlerësohet maksimalisht me 50 pikë.

4.6 Testi për secilin nga provimet me zgjedhje përmban 20 pyetje, nga të cilat 10 pyetje janë me përgjigje alternative, që vlerësohen me një pikë secila (10 pikë gjithsej) dhe 10 pyetje me zhvillim, që vlerësohen me tri pikë secila (30 pikë gjithsej). Testi vlerësohet maksimalisht me 40 pikë.

4.7 Maturantët/kandidatët që japin provim vetëm njëherë nga lëndët me zgjedhje, e fillojnë provimin në orën 11:30 dhe e përfundojnë atë në orën 13:00.

4.8 Maturantët/kandidatët që rezultojnë mbetës në provimet e Maturës Shtetërore 2017, i rijapin ato provime në sesionin e dytë.

5. DAR/ZA-të të marrin nga shkollat listat e maturantëve mbetës të vitit shkollor 2016–2017,



brenda datës 3 qershor 2017, t'i pasqyrojnë ato në sistemin elektronik "Portali i maturantit", sipas udhëzimit përkatës dhe t'i dërgojnë këto lista në AKP, në format të printuar dhe elektronik.

5.1 Drejtoritë e shkollave të njoftojnë maturantët mbetës, që të mos paraqiten në provimet e Maturës Shtetërore 2017, pa likuiduar më parë provimet e klasës.

5.2 Organizimi i konsultimeve për maturantët të kryhet sipas procedurave të përcaktuara në urdhrin e ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 121, datë 25.2.2011, "Për organizimin e konsultimeve në ndihmë të nxënësve maturantë".

5.3 Teza e provimit "Gjuhë dhe letërsi greke", për shkollën e mesme pedagogjike të pakicës kombëtare greke, përgatitet nga DAR-ja Gjirokastër.

5.4 Teza e provimit "Gjuhë dhe letërsi italiane" (Lingua e literatura italiana) për seksionet dygjuhëshe shqiptaro-italiane përgatitet nga Ministria e Arsimit e Republikës së Italisë dhe provimi zhvillohet në datën 24 maj 2017 në shkollat përkatëse.

5.5 Teza e provimit "Gjuhë frënge" (DEL F B2 scolaire) për seksionet dygjuhëshe shqiptaro-franceze përgatitet nga Ambasada Franceze dhe provimi zhvillohet në datën 24 maj 2017 në shkollat përkatëse.

5.6 Tërheqja e testeve të provimeve të Maturës Shtetërore 2017 të bëhet sipas grafikut të hartuar nga AKP-ja dhe të miratuar nga MAS-i. Përfaqësuesit e Postës Shqiptare tërheqin në AKP materialet e provimit, një ditë para zhvillimit të provimit përkatës. Materialet e provimit të paketohen për çdo mjedis më vete. Shpërndarja dhe grumbullimi i materialeve të provimit të bëhet mbështetur në Rregulloren e Maturës Shtetërore 2017 në Republikën e Shqipërisë.

5.7 Provimet kombëtare të Maturës Shtetërore 2017 zhvillohen në mjediset e institucioneve arsimore, mbështetur në Rregulloren e Maturës Shtetërore 2017 në Republikën e Shqipërisë.

6. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit Parauniversitar dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Provimeve, Inspektorati Shtetëror i Arsimit, njësitë arsimore vendore dhe shkollat.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla

VENDIM
Nr. 19, datë 10.3.2017

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

| | | | |
|-----------------|--------------------------------|---|---|
| Bashkim Dedja | kryetar i Gjykatës Kushtetuese | | |
| Vladimir Kristo | anëtar i | " | " |
| Altina Xhoxhaj | anëtare e | " | " |
| Fatmir Hoxha | anëtar i | " | " |
| Gani Dizdari | anëtar i | " | " |
| Besnik Imeraj | anëtar i | " | " |
| Fatos Lulo | anëtar i | " | " |

me sekretare gjyqësore Belma Lleshi, në datën 10.3.2017, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 6, Akti, që i përket:

KËRKUES: Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, z. Bashkim Dedja

OBJEKTI: Për deklarinimin e mbarimit të mandatit të anëtares së Gjykatës Kushtetuese, znj. Vitore Tusha.

BAZA LIGJORE: Nenet 127/b dhe 127/2 të Kushtetutës, nenet 8/3 dhe 9/2, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, ndryshuar me ligjin nr. 99/2016, datë 6.10.2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë".

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatimin e bërë nga Kryetari dhe administroi dokumentacionin e çështjes,

VËREN:

Presidenti i Republikës së Shqipërisë, me dekretin nr. 5614, datë 11.2.2008, ka emëruar znj. Vitore Tusha anëtare të Gjykatës Kushtetuese. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, me vendimin nr. 158, datë 18.2.2008, ka dhënë pëlqimin për emërimin e znj. Tusha si anëtare të Gjykatës Kushtetuese.

Në datën 10.3.2008 znj. Tusha ka bërë betimin para Presidentit të Republikës. Sipas nenit 8/3 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, ndryshuar me ligjin



nr. 99/2016, datë 6.10.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, përcaktohet se *mandati i gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese fillon nga data e betimit dhe mbaron në datën e njëjtë të atij muaji, të vitit të nëntë, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon ndryshe*. Për rrjedhojë, data 10.3.2017 konsiderohet data e mbarimit të mandatit të znj. Vitore Tusha.

Në përputhje me nenin 127/2 të Kushtetutës, si dhe nenin 9/2 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, ndryshuar me ligjin nr. 99/2016, datë 6.10.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, ku përcaktohet se, mbarimi i mandatit të gjyqtarit deklarohet me vendim të Gjykatës Kushtetuese dhe kërkesa për deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit bëhet nga Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, Kryetari paraqiti para kësaj Gjykate kërkesën për deklarimin e mbarimit të mandatit të anëtares së Gjykatës Kushtetuese, znj. Vitore Tusha.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 127/b dhe 127/2 të Kushtetutës, si dhe të nenit 8/3 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, ndryshuar me ligjin nr. 99/2016, datë 6.10.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSI:

- Deklarimin e mbarimit të mandatit të anëtares së Gjykatës Kushtetuese znj. Vitore Tusha në datën 10.3.2017.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi menjëherë.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Fatmir Hoxha, Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Altina Xhoxhaj, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

NJOFTIM

Nr. 3515, datë 15.3.2017

MBI HYRJEN NË FUQI TË DISA MARRËVESHJEVE NDËRKOMBËTARE

1. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Italisë për konvertimin e borxhit për zhvillim, nënshkruar më 17.6.2016, hyrë në fuqi më 6.2.2017.

2. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin në fushën e sigurisë, nënshkruar më 31.5.2013, hyrë në fuqi më 23.2.2017.

3. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mongolisë për përjashtimin nga kërkesa për vizë të mbajtësve të pasaportave biometrike diplomatike, shërbimit dhe zyrtare”, nënshkruar në Gjenevë, më 28.2.2017, hyrë në fuqi më 29.3.2017.

4. Marrëveshje ndryshuese nr. 1 e Marrëveshjes për kontrollin e lëndëve narkotike dhe zbatimin e ligjit, i datës 1 korrik 2015, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, nënshkruar më 21.9.2016, hyrë në fuqi datën e nënshkrimit.

5. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kabinetit të Ministrave të Ukrainës për heqjen e ndërsjellë të kërkesave për vizë, nënshkruar në Tiranë, më 4.11.2016, hyrë në fuqi më 1.4.2017.

6. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë mbi Bashkëpunimin Financiar 2016 për projektin “Linja e transmetimit 400 kV Shqipëri–Maqedoni”, nënshkruar më 26.7.2016, hyrë në fuqi më 8.3.2017.

7. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë mbi Bashkëpunimin Financiar 2016 për projektin “Linja e transmetimit 400 kV Shqipëri–Maqedoni (zgjerim)”, nënshkruar më 28.10.2016, hyrë në fuqi më 8.3.2017.

8. Marrëveshje e Huas ndërmjet KfW Frankfurt am Main dhe Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave Huamarrësi, për financimin e Programit të Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta, Rajoni Vlorë, nënshkruar më 15.12.2016, hyrë në fuqi më 13.3.2017.

9. Marrëveshje Financimi ndërmjet Republikës së Shqipërisë përfaqësuar nga Ministria e Financave si Marrës dhe KfW Frankfurt am Main, për financimin e Shërbimeve të Ekspertit ndaj Marrësit në kuadër të një studimi për menaxhimin e integruar të mbetjeve të ngurta në Shqipëri nga një fond i



veçantë (nr. 11469), dhënë nga qeveria gjermane, nënshkruar më 15.12.2016, hyrë në fuqi më 13.3.2017.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM I
MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME
Gazmend Barbullushi

VENDIM
Nr. 34, datë 2.3.2017

**MBI MIRATIMIN E UDHËZIMIT MBI
KRITERET PËR PËRCAKTIMIN E
AKSESIT NË HAPËSIRAT E
DEPOZITIMIT TË GAZIT NATYROR**

Në mbështetje të neneve 16, pika 6 dhe 63 të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror” dhe neneve 15 dhe 26 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 2.3.2017, mbasi shqyrtoi draftin e përgatitur nga drejtoritë teknike për udhëzimin “Mbi kriteret për përcaktimin e aksesit në hapësirat e depozitimit të gazit natyror”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 8, datë 19.1.2017, filloi procedurat për shqyrtimin dhe miratimin e udhëzimit “Mbi kriteret për përcaktimin e aksesit në hapësirat e depozitimit të gazit natyror”.

- ERE, me shkresën nr. 100/2 prot., datë 27.1.2017, publikoi për 3 ditë me radhë në medien e shkruar njoftimin për vendimmarrjen e sipërcituar të Bordit.

- Me shkresën nr. 92 prot., në datën 26.1.2017, ERE dërgoi draft-udhëzimin “Mbi kriteret për përcaktimin e aksesit në hapësirat e depozitimit të gazit natyror”, për marrje mendimi, pranë subjekteve: MEI, AK, “Albpetrol” sh.a., ISHTI, “Phoenix Petroleum” sh.p.k. dhe “ANIO Oil & Gas” sh.a.

- ISHTI, me shkresën nr.628/1 prot., datë 7.2.2017, shprehet se është dakord në parim për miratimin e projekt-udhëzimit duke e vlerësuar atë në përputhje me normat dhe standardet europiane.

- Autoriteti i Konkurrencës, me shkresën nr. 34/1 prot., datë 28.2.2017, u shpreh se projekt-udhëzuesi në parim nuk bie në kundërshtim me ligjin nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Faqe | 3380

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë udhëzimin “Mbi kriteret për përcaktimin e aksesit në hapësirat e depozitimit të gazit natyror” (bashkëlidhur).

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

UDHËZIM

**MBI KRITERET PËR PËRCAKTIMIN E
AKSESIT NË HAPËSIRAT E DEPOZITIMIT
TË GAZIT NATYROR**

I. Dispozita të përgjithshme

- Udhëzimi mbi kriteret për përcaktimin e aksesit në hapësirat e depozitimit të gazit natyror (këtu dhe më poshtë udhëzimi) përcakton kriteret sipas të cilave vendoset regjimi i negociuar ose i rregulluar i aksesit për çdo hapësirë depozitimi të gazit natyror në Shqipëri (këtu dhe më poshtë “Kriteret”).

- Qëllimi i këtij udhëzimi është të sigurojë një treg transparent dhe që funksionon mirë për depozitimin e gazit natyror në Shqipëri, po ashtu të ofrojë fleksibilitet dhe mjete për sigurinë e furnizimit për përdoruesit e rjetit në mënyrë që të furnizojnë konsumatorët e tyre në Shqipëri, gjë që do të kontribuojë në një treg të integruar dhe konkurrues të gazit natyror në Komunitetin e Energjisë.

- Në këtë udhëzim të gjitha termat janë përdorur sipas kuptimit të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” (këtu dhe më poshtë “Ligji”).

II. Qëllimi i aplikimit

- Ky udhëzim do të aplikohet për depozitimin e gazit nga operatorët që do të operojnë në Shqipëri sipas ligjit në rastet kur është teknikisht dhe/ose ekonomikisht e nevojshme për të siguruar akses eficient për furnizimin e konsumatorëve.

- Bazuar në këtë udhëzim, Enti Rregullator i Energjisë (këtu dhe më poshtë “ERE”) duhet të



marrë masat e nevojshme për të siguruar akses jodiskriminues në rastet kur aplikohet regjimi i negociuar i aksesit, ose për të miratuar tarifat për akses në rastet kur aplikohet regjimi i rregulluar i aksesit.

- Bazuar në këtë udhëzim dhe raportit të miratuar nga ERE sipas paragrafit 15, ERE do të miratojë regjimin e rregulluar ose atë të negociuar të aksesit, në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese për çdo hapësirë depozitimi.

III. Kriteret për të përcaktuar regjimin e aksesit

- ERE do të përgatisë një raport duke iu referuar paragrafit 15 të këtij udhëzimi bazuar në kriterin e specifikuar këtu. Bazuar në këtë raport, ERE do të vendosë për regjimin e aksesit në bazë të konkluzioneve të raportit dhe do të justifikojë vendimin e saj.

- Kriteret për përcaktimin e regjimit të aksesit nga ERE përfshijnë si më poshtë:

- kriteret në lidhje me konkurrencën me burime të tjera të fleksibilitetit, çmimet e depozitimit dhe rolin e depozitimit në treg, përgjigjet pozitive të të cilit duhet të favorizojnë regjimin e rregulluar të aksesit;

- kriteret në lidhje me kushtet e tregut për depozitimin dhe sigurinë e furnizimit përgjigjet pozitive të të cilit duhet të favorizojnë regjimin e rregulluar të aksesit;

- raporti i referuar në paragrafin 15 të udhëzimit duhet të përmbajë një algoritëm për të vlerësuar rëndësinë e kriterëve të përcaktuara si më poshtë.

a) Kriteri në lidhje me konkurrencën

- Në lidhje me rolin e depozitimit në një treg fleksibël, ERE duhet të vlerësojë:

- nëse hapësira e depozitimit është në gjendje që të përballojë pikun sezonal të dimrit;

- nëse ekziston në treg konkurrenca efektive midis hapësirave të depozitimit ose midis hapësirave të depozitimit dhe shërbimeve të tjera fleksibël (siç janë: kapaciteti i importit, fleksibiliteti në prodhim, kapaciteti i importit të GNL, kontratat e importit, tregtimi në pikat/qendrat e shkëmbimit të gazit);

- në rast se nuk ka konkurrencë efektive në vend, a ka ndonjë perspektivë të mundshme që në një kohë të shkurtër që kjo konkurrencë të ndodhë, së bashku me zhvillimin e presioneve konkurruese midis hapësirave të depozitimit ose midis hapësirave të depozitimit dhe burimeve të tjera fleksibël;

- nëse ka një perspektivë të mundshme që një hapësirë depozitimi të jetë në konkurrencë me hapësirat e depozitimi të vendeve fqinjë, veçanërisht, me ato të Evropës Juglindore; dhe

- nëse përgjigja e pyetjes në paragrafin 10.4 është PO, a është regjimi që aplikohet për hapësirat e mundshme konkurruese të depozitimit në Europën Juglindore një regjim aksesi i negociueshëm.

b) Kriteri në lidhje me çmimet e depozitimit

- ERE duhet të vlerësojë, në rastet kur tarifa e depozitimit për një hapësirë është e rregulluar:

- nëse humbjet e Operatorit të Sistemit të Depozitimit kanë ndodhur për shkak të çmimeve të ulura; dhe

- nëse tarifa e depozitimit ishte një dekurajim për investimet në një hapësirë depozitimi.

c) Roli i depozitimit në tregun e gazit

- ERE duhet të vlerësojë rolin e depozitimit për tregjet e gazit natyror në Shqipëri dhe Evropë dhe veçanërisht:

- nëse numri dhe madhësia e hapësirave të depozitimit në Shqipëri është në proporcion me numrin dhe madhësinë e hapësirave të depozitimit në vendet e tjera të Evropës;

- nëse madhësia e kapacitetit total të depozitimit është në mënyrë proporcionale e lartë me kërkesën vjetore të Shqipërisë për gaz;

- nëse operatori i depozitimit mund të përshtatë shërbime të tjera sipas zhvillimit të tregut në Shqipëri dhe tregjeve të vendeve fqinje; dhe

- nëse kushtet gjeologjike të vendit janë të favorshme për zhvillimin e mundshëm të hapësirave të tjera të depozitimit.

d) Kriteri që lidhet me kushtet e tregut për depozitimin

- ERE duhet të vlerësojë aksesin efektiv tek depozitimet, veçanërisht:

- nëse kapaciteti rezervohet më shumë nga një apo nga disa kompani të mëdha;

- nëse ka një proporcion të lartë rezervimi për kapacitetin e hapësirave në një afat të shkurtër;

- nëse ka një sasi relativisht të vogël të kapacitetit në dispozicion; dhe

- nëse kapaciteti në dispozicion jepet në mënyrë diskriminuese.

e) Roli i depozitimit për sigurinë e furnizimit

- ERE duhet të vlerësojë rolin e ndikimit të masave që kanë të bëjnë me sigurinë e furnizimit në lidhje me depozitimet dhe veçanërisht:



- nëse kapaciteti i depozituar është ndarë si një rezervë strategjike apo ka një funksion të ngjashëm për nevojat e konsumatorëve shqiptarë; dhe

- nëse detyrimet e vendosura për furnizuesit që kanë lidhje me sigurinë e furnizimit përballojnë depozitimin e një pjese proporcionalisht të madhe në depozitimet e tyre të gazit.

IV. Përcaktimi i regjimit të aksesit

- ERE duhet të publikojë rezultatet e vlerësimit të kriterëve në një raport të përmbledhur. Fillimisht raporti duhet të përgatitet dhe publikohet nga ERE në datën e përcaktuar nga ERE.

- ERE duhet të zgjedhë midis regjimit të aksesit të negociuar ose regjimit të aksesit të rregulluar për depozitimet, sipas konkluzioneve të raportit.

- Operatorët e sistemit të depozitimit duhet të aplikojnë regjimin për çdo hapësirë depozitimi si vendoset nga ERE dhe të publikojnë vendimin në faqen e tyre të internetit. Operatorët e sistemit të depozitimit duhet të publikojnë kushtet kryesore tregtare për përdorimin e depozitave, linepack dhe shërbimeve ndihmëse, për periudhën aktuale.

- Çdo operator i sistemit për depozitimin është i detyruar të lejojë akses tek hapësirat e depozitimit në përputhje me kodin përkatës të depozitimit, pavarësisht regjimit të aksesit që ka aplikuar.

V. Monitorimi i aplikimit të kriterëve

- ERE duhet të monitorojë aplikimin e duhur të kriterëve nga operatorët e sistemit të depozitimit. ERE mund të nxjerrë udhëzime për operatorin e sistemit të depozitimit në rast se është negociuar regjimi i aksesit që do të aplikohet.

- Bazuar në rezultatet e monitorimit, ERE mund të dalë në përfundimin se është i nevojshëm ndryshimi i regjimit të aksesit ose mund të vendosë që të ndryshojë regjimin e aksesit të aplikuar.

- ERE duhet të justifikojë vendimin për ndryshimin e regjimit të aplikuar për aksesin dhe ta publikojë atë në faqen e internetit.

- Asnjë gjë në këto udhëzime nuk duhet të ndalojë ERE nga detyrat dhe kompetencat e saj në lidhje me monitorimin dhe rishikimin e kushteve të aksesit për depozitimin.

VI. Dispozitat përfundimtare

- ERE duhet të rishikojë kriteret të paktën çdo 3 (tre) vjet, duke marrë parasysh rezultatin nga operatorët e sistemit të depozitimit, përdoruesit e sistemit të depozitimit dhe treguesit.

- Mbas miratimit dhe publikimit në Fletoren Zyrtare të Shqipërisë udhëzimi dhe kriteret e

vlerësimit të kryer nga ERE duket të publikohen në faqen e internetit të ERE-s.

- Interpretimi i këtij udhëzimi duhet të sigurohet dhe të njoftohet publikisht nga ERE sipas rregullave procedurale.

- Personat, të cilët nuk zbatojnë këto udhëzime ose vendimet përkatëse të miratuara nga ERE, janë përgjegjës sipas ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

VENDIM

Nr. 35, datë 2.3.2017

MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT PËR CERTIFIKIMIN E OPERATORIT TË KOMBINUAR TË GAZIT NATYROR TË “ALBGAZ” SHA

Bazuar në nenet 13, 36, 37 dhe 80, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, vendimit të Këshillit Ministerial nr. D/2011/02/MC-EnC, Traktatit të Komunitetit të Energjisë, të ratifikuar me ligjin nr. 9501, datë 3.4.2006, nenet 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11, pika 3, të “Rregullave për certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror”, të miratuar me vendimin nr. 100, datë 5.8.2015, të Bordit të ERE-s, të ndryshuar, me vendimin nr. 129, datë 31.10.2015, të Bordit të ERE-s, nenit 19, pika 1, germa “b”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 2.3.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike, mbi aplikimin për certifikimin e operatorit të kombinuar të gazit natyror të “Albgaz” sh.a.

Duke konsideruar që:

- Shoqëria “Albgaz” sh.a., me shkresën nr. 166 prot., datë 20.2.2016, regjistruar në ERE, ka paraqitur kërkesën për certifikimin në aktivitetin e operatorit të kombinuar të gazit natyror të “Albgaz” sh.a.

- Kjo kërkesë për miratim, mbështetet në sa përcaktuar në nenet 37 dhe 80, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror” dhe “Rregullave për certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror” të miratuar me vendimin nr. 100, datë 5.8.2015, të Bordit të ERE-s, të ndryshuar, si dhe VKM. nr. 848, datë 7.12.2016 “Për krijimin e shoqërisë



“Albgaz” sh.a. dhe përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive “Albpetrol” sh.a. dhe “Albgaz” sh.a.”, e cila përcakton se: “Me regjistrimin në QKB, shoqëria “Albgaz” sh.a., të aplikojë pranë Entit Rregullator të Energjisë për certifikim, si operator transmetimi, sipas procedurave të përcaktuara në nenin 37, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, si dhe për pajisjen me licencë për transmetimin e shpërndarjen e gazit natyror, në përputhje me procedurat e përcaktuara në nenet 22, 23 dhe 24, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

- Për efekt të këtij aplikimi nga “Albgaz” sh.a., bashkë me kërkesën me shkrim për certifikim janë depozituar dokumentet e parashikuara në nenin 9 të “Rregullat për certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror”, miratuar me vendimin e ERE-s nr. 100, datë 5.8.2015 dhe ndryshuar me vendimin nr. 129, datë 31.10.2015.

- Dokumentet, të dhënat dhe informacioni i kërkuar sipas nenit 9, të rregullores janë paraqitur në ERE me shkrim dhe në mënyrë elektronike.

- ERE ruan konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregtar por mund të kërkojë nga “Albgaz” sh.a., çdo informacion të nevojshëm për qëllim të certifikimit referuar ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

- ERE në cilësinë e autoritetit përgjegjës për rregullimin e sektorit të gazit natyror dhe në përputhje me ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, si dhe të detyrimeve sipas Traktatit të Komunitetit të Energjisë ratifikuar me ligjin nr. 9501, datë 3.4.2006, ka miratuar me vendimin nr. 100, datë 5.8.2015 dhe ndryshuar me vendimin nr. 129, datë 31.10.2015 “Rregullat për certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror”.

- Neni 9 i vendimit të Këshillit Ministerial nr. D/2011/02/MC-EnC dhe neni 38 i ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, parashikon që ERE duhet të vërë në dijeni Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë për vendimin e shprehur apo të pashprehur me fjalë për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit për certifikimin e operatorit të kombinuar të gazit natyror “Albgaz” sh.a.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit t’i përcjellë këtë vendim Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit t’i përcjellë këtë vendim Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes, Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë dhe Autoritetit të Konkurrencës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 36, datë 6.3.2017

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ENPI ENERGI” SHPK, NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 5, germa “e”; 13 dhe 21, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016 dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.3.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për licencimin e shoqërisë “ENPI Energi” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 21, datë 31.1.2017, ka vendosur “Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit për licencim të shoqërisë “ENPI Energi” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike”.



Aplikimi i shoqërisë “ENPI Energji” sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4/8, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “ENPI Energji” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 37, datë 6.3.2017

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “BALKAN ENERGY TRADE” SHPK, NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “d” të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 5, germa “e”; 13 dhe 21 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109,

datë 29.6.2016 dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.3.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për licencimin e shoqërisë “Balkan Energy Trade” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Balkan Energy Trade” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4/8, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Balkan Energy Trade” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti



VENDIM
Nr. 38, datë 6.3.2017

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË
“ENERGJI UNIVERS” SHPK NË
AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC
“KABASH” ME FUQI TË INSTALUAR
5800 KW**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “a”, 39, pika 3 e ligjit nr. 43/2015 “për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “a”; 5, pika 1, germa “a” dhe 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.3.2017, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Energji Univers” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie nga HEC “Kabash”,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Energji Univers” sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni tekniko-ekonomik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Energji Univers” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë

elektrike nga HEC “Kabash”, me fuqi të instaluar 5800 KW, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 39, datë 6.3.2017

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË “GRID
ENERGY” SHPK, NË AKTIVITETIN E
FURNIZIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe në zbatim neneve 4, pika 1, germa “d”; 5, pika 1, germa “d” dhe 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016; neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.3.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Grid Energy” sh.p.k., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Grid Energy” sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1 gjerat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.



- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7, gjerat “a”, “b”, “c”, “e”, “f”, “a1” dhe “b1”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Grid Energy” sh.p.k., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 40, datë 6.3.2017

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “GRID ENERGY” SHPK, NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe në zbatim të neneve 4, germa “e”; 5, pika 1, germa “e”; 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016; neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.3.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë

“Grid Energy” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Grid Energy” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, gjerat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë “Grid Energy” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 41, datë 6.3.2017

PËR MOSFILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “CGC” SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË GAZIT NATYROR (SHITJE ME SHUMICË)

Në mbështetje të nenit 4, pikat 50, 105, 107; nenit 22, pika 2, germa “ç”; nenit 83, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”; neneve 4,



pika 1, germa “ç”; 8, 9, pika 1, germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”; pika 2, germa “e” dhe nenin 10, pika 1 të “Rregullave dhe procedurave për licencimin, ndryshimin, transferimin e pjesshëm ose të plotë, heqjen dhe rinovimin e licencave në sektorin e gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 9, datë 11.2.2011; nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.3.2017, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “CGC” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për licencimin në aktivitetin e tregtimit të gazit natyror të shoqërisë “CGC” sh.p.k.,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “CGC” sh.p.k. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, si më poshtë:

- Formatit dhe dokumentacioni për aplikim (neni 9, pika 1, germat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni ligjor, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 1, germa d/i, d/ii) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni dhe garancitë financiare dhe fiskale (neni 9, pika 1, germa e/i, e/ii, e/v, e/vi) janë plotësuar në mënyrë korrekte.

Rezultoni dokumentacioni i munguar që ka të bëjë me:

- nenin 9, pika 1, germa d/V, d/VI, dokumentacioni ligjor, administrativ dhe pronësor;

- nenin 9, pika 1, germa e/iii, dokumentacioni dhe garancitë financiare dhe fiskale;

- nenin 9, pika 2, germa e/i, e/ii, e/iii, dokumentacioni specifik për llojin e licencës.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të mosfillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “CGC” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të gazit natyror (shitje me shumicë).

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

KËRKESË

Nr. 1594, datë 10.3.2017

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Zhvillimit Urban shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, “Rikualifikim urban në territorin e Bashkisë Vlorë”, faza I.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia Vlorë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Vlera totale shpronësimit është **55,686,002 (pesëdhjetë e pesë milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e dy) lekë.**

ZËVENDËSMINISTËR I ZHVILLIMIT
URBAN
Gjon Radovani



LISTA E PASURIVE QE PREKEN NGA PROJEKTI:
 “RIKUALIFIKIM URBAN, ME VENDNDODHJE NE TERRITORIN E BASHKISE VLORE” Faza I

Çmimi i truallit sipas vkm 89/2016

Çmimi per banesat konform VKM 138 date 23.03.2000 konfirmuar sipas ZVRPP

Çmimi per njesite e sherbimit , konform VKM 138 date 23.03.2000 sipas çmimeve te EKB

| Nr. | Zk. | Nr.pasurise | Adresa | Pronari | Sip.truallit | Sip.nderti | Cmimi i truallit | Vlera e truallit leke | Vlera e ndertimit leke | Vlera e truallit dhe e ndertesese | Shënime |
|-------------------|------|-------------|--------|--|--------------|------------|------------------|-----------------------|------------------------|-----------------------------------|-------------------------|
| 1 | 8605 | 6/272 | Vlore | Bp. Gunbardhi, Velaj, Tartari Bp Agalliu (Fitnete, Afrim,Dashamir,Marjana,Teferi Agalliu) | 1778 | 0 | 8,300.00 | 14,757,400.00 | | 14,757,400.00 | Plotësim dokumentacioni |
| 2 | 8605 | 6/240 | Vlore | | 1000.5 | 0 | 8,300.00 | 8,304,150.00 | | 8,304,150.00 | Plotësim dokumentacioni |
| 3 | 8605 | 6/241 | Vlore | Bp. Xhemali (Hajri Xhemali, Avni Xhemali,Zaide Xhemali, Agim Xhemali) | 432 | 0 | 8,300.00 | 3,585,600.00 | | 3,585,600.00 | Plotësim dokumentacioni |
| 4 | 8605 | 6/242 | Vlore | Bp. Xhemali (Hajri Xhemali, Avni Xhemali,Zaide Xhemali, Agim Xhemali) | 572 | 0 | 8,300.00 | 4,747,600.00 | | 4,747,600.00 | Plotësim dokumentacioni |
| 5 | 8605 | 6/66-nd/3 | Vlore | Agim Xhemali | 0 | 99 | - | - | 2,442,758.00 | 2,442,758.00 | Plotësim dokumentacioni |
| 6 | 8605 | 6/169 | Vlore | Bp Agalliu | 36 | 0 | 8,300.00 | 298,800.00 | | 298,800.00 | Plotësim dokumentacioni |
| 7 | 8605 | 6/159 | Vlore | Bp Agalliu | 113.5 | 0 | 8,300.00 | 942,050.00 | | 942,050.00 | Plotësim dokumentacioni |
| 8 | 8605 | 11./92 | Vlore | Bp.Sorra,Agalliu, Topallaj, Velaj, Barakaj,Haxhi,Zinxhiria,Cobani, Graceni, Qemalli | 1329 | 0 | 8,300.00 | 11,030,700.00 | | 11,030,700.00 | Plotësim dokumentacioni |
| 9 | 8605 | 11/176 | Vlore | Bp.Agalliu | 61 | 0 | 8,300.00 | 506,300.00 | | 506,300.00 | Plotësim dokumentacioni |
| 10 | 8605 | 11/177 | Vlore | Bp.Lulja | 350 | 0 | 8,300.00 | 2,905,000.00 | | 2,905,000.00 | Plotësim dokumentacioni |
| 11 | 8605 | 11/178 | Vlore | Bp.Kokona, Bino,Celaj,Polloj, Ballii | 31 | 0 | 8,300.00 | 257,300.00 | | 257,300.00 | Plotësim dokumentacioni |
| 12 | 8605 | 11/179 | Vlore | Bp.Agalliu | 7.3 | 0 | 8,300.00 | 60,590.00 | | 60,590.00 | Plotësim dokumentacioni |
| 13 | 8602 | 11/180 | Vlore | Porina Mucaj | 29.5 | 29.5 | 10,903.00 | 321638.5 | 1,385,409.00 | 1,707,047.50 | Plotësim dokumentacioni |
| 14 | 8602 | 11/181 | Vlore | Bp.Bojaxhi | 25 | 0 | 10,903.00 | 272,575.00 | | 272,575.00 | Plotësim dokumentacioni |
| 15 | 8602 | 11/182 | Vlore | Bp.Bojaxhi | 75 | 0 | 10,903.00 | 817,725.00 | | 817,725.00 | Plotësim dokumentacioni |
| 16 | 8602 | 11/183 | Vlore | David Dema | 4 | 4 | 10,903.00 | 43,612.00 | 180,127.00 | 223,739.00 | Plotësim dokumentacioni |
| 17 | 8602 | 11/184 | Vlore | Sabit Rakipi | 70.2 | 49.6 | 10,903.00 | 765,390.60 | 2,061,277.00 | 2,826,667.60 | Plotësim dokumentacioni |
| shuma leke | | | | | | | | | | 55,686,002.10 | |

**KËRKESË**

Shtetasja Imelda Spahiu, e bija e Fetahut dhe e Fluturës, e datëlindjes 18.6.1978, lindur në fshatin Zerqan dhe banuese në Peshkopë, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër shpalljen të zhdukur të shtetasit Sali (Mikel) Spahiu, i biri i Pllumbit dhe i Muzaferes, i datëlindjes 14.4.1976, lindur në fshatin Sohodoll Dibër, si dhe caktimin si kujdestare në administrimin e pasurisë së tij shtetasen Imelda Spahiu.

KËRKUESE
Imelda Spahiu

KËRKESË

Shtetasja Gjenovefa Ndrio, e bija e Timothea dhe Kalianthi, lindur më 21.12.1937 dhe banuese në Vlorë, kërkon, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, shpalljen të vdekur të djalit të saj shtetasit Elidon Thoma Ndrio, i biri i Thomait dhe i Gjinovefës, lindur në Vlorë më 12.5.1973 dhe vdekur më 12.10.1993.

KËRKUESE
Gjenovefa Ndrio

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 112 lekë